



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Gjirokastrër, më 14/09/2021

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin Mesdhetar Grek të Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti Mesdhetar Grek i Kretës ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:
2 pozicione për studentë të cilët do të angazhohen në trajnim/ shkëmbim eksperiencash për 5 muaj në Universitetin e Kretës.

Planifikimi i aktivitetit mësimor/ mësimdhënës/ mësimnxënës do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2021-2022**, semestri i parë dhe i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B1 për studentët dhe B2 për stafin akademik për mësimdhënie. Sipas të dhënave nga Universiteti i Kretës, aplikimet janë të hapura për çdo Departament.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **27.09.2021**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht, e cila cilëson fushën tuaj studimore dhe që përshkruan ciklin e leksioneve që mendoni të zhvilloni në Universitetin e Kretës.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Universitetit Mesdhetar të Kretës, Greqi, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Memari

REKTOR

